



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të Rregullores nr. 01/2017, neni 31 paragrafi 2, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe Vendimit nr.01-95-2023, të datës 27.01.2023 për miratimin e planit të rekrutimit për vitin 2023, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rishpall:

## K O N K U R S

### Për plotësimin e vendeve të punës

- 1. KOZ- 12/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut;**
- 2. KOZ- 13/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Leposavic;**
- 3. KOZ- 14/20223: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zubin Potok;**
- 4. KOZ- 15/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zveçan;**

**Grada/Koeficienti:** Niveli Profesional- G6 /13.5  
**Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë:** Drejtori i Departamentit të Koordinimit në Teren  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Pa afat, pas periudhës provuese 12 muaj

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:**

1. Kryeson Komisionin Komunal Zgjedhor në bashkëpunim të plotë me Sekretariatit e KQZ – së;
2. Përkujdeset për zbatimin e aktiviteteve dhe të gjitha akteve normative të nxjerra nga KQZ dhe Sekretariati në komunën përkatëse;
3. Mbikëqyrë dhe u cakton detyra anëtarëve të tjerë të KKZ –së;
4. Mbikëqyrë punën e trupave zgjedhore në komunën përkatëse;
5. Bën raporte për aktivitetet në periudhën zgjedhore dhe jo zgjedhore;
6. Koordinon aktivitetet në mes KKZ-së dhe Administratës Komunale dhe SKQZ-së;
7. Procedon në SKQZ kërkesat e Kuvendit Komunal për zëvendësimet e këshilltarëve komunal;
8. Ndihmon dhe këshillon subjektet politike dhe organizatat joqeveritare për zgjedhje;
9. Kryen detyra të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësi.

#### **Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:**

1. Të ketë diplomë universiteti në lëmin e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, administrim të zgjedhjeve, shkencë sociale, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhment ose në statistikë;
2. Së paku katër (4) vite përvojë pune;
3. Integritet të lartë personal dhe profesional;
4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare;

5. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare konsiderohet si përparësi;
7. Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
8. Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access);

*Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës,, Rruga “Migjeni” 10000 Prishtinë, përmes postës elektronike në adresën: [zyra.personeli@kqz-ks.org](mailto:zyra.personeli@kqz-ks.org) dhe me anë të shërbimit postar.*

*Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org). Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.*

*Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi: **kualifikimin, përvojën e punës dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni, certifikatën që nuk jeni nën hetime, si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar.***

***Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve (ZLKZ) duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunat e tyre përkatëse.***

*Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit, prej datës: **24.02.2023 deri me datë: 13.03.2023** në ora 16:00.*

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.*